



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 85

Prishtinë, më 29.11.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj dhe Pal Lekaj.

Munguan: Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dren Ajeti- GLPS; Dibran Istrefi- Klan KOSOVA; Besim Morina- IGJK; Lumnije Murati – ZPRK; Eset Rama dhe Ramadan Bytyçi-MD; Lavdim Krasniqi- SPRK; Ramadan Gashi- ANJF; Gresa Ramadani- Vizitor; Fjolla Uka- KDI; Albulena Nuha-RTV 21; Jasin Zeqiri dhe Drita Vitia- Kosova Press; Miradije Meha dhe Enis Halimi-KQZ; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Jeta Krasniqi dhe Violeta Haxholli- KDI; Sanije Berisha, OSBE; Valdete Osmani- RTK; Shefki Kastrati dhe Rinor Beka- NDI.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Nga Stafi Mbështetës: Visar Krasniqi dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.10.2016;
3. Diskutim lidhur me buxhetin e Institucioneve/ Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;
4. Njoftim me shkresën e Institutit Gjyqësor të Kosovës për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Diskutim për prezantimin e projektit të KDI-së lidhur me Komisionin për Legjislacion. Kërkesë nga Grupi për Studime Politike dhe Juridike për Javën Kundër Korrupsion për caktimin e një Dëgjimi Publik nga Komisioni, dhe po ashtu një vizitë në Tiranë pas ftesës që kemi marrë nga Komisioni i Ligjeve.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.10.2016

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin, nga mbledhja e mbajtur me 18.10.2016, pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me buxhetin e Institucioneve/Agjencive që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion

Kryetarja tha se ne, në Kuvendin i Republikës së Kosovës, kemi pranuar projektligjin për buxhet të vitit 2017 dhe tani më kemi filluar të praktikojmë edhe shqyrtimin e buxhetit të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit. Arsyja pse ju kemi ftuar është që t'i paraqisni prioritetet e juaja buxhetore dhe sidomos prioritetet që i keni për vitin e ardhshëm në mënyrë që komisioni të kërkojë nga Komisioni për Buxhet dhe po ashtu edhe nga Kuvendi Kosovës që të ketë ndonjë amendament për buxhetin që ju keni nevojë. Znj. Haxhiu tha se ka analizuar buxhetin e institucioneve që janë në fushëveprim të Komisionit dhe më tej mbetet të mos ketë ndryshime në buxhet nga viti i kaluar duke pohuar se ende Qeveria nuk ka ndarë buxhet për sistemin e drejtësisë por edhe për Institucionet/Agjencitë e Pavarura. Nuk e di se si mund të ketë ndryshim në sistem të drejtësisë, por po ashtu edhe në forcim të institucioneve të tjera për sa kohë nuk është reflektuar me buxhet. Më tej znj. Haxhiu i ftoi përfaqësuesit e institucioneve/agjencive të marrin fjalën që t'i paraqesin kërkesat buxhetore.

Ramadan Gashi, ANJF, tha se ne kemi qenë dy vjet me një kërkesë dhe fatmirësisht pjesa minimale e kërkesës është futur në buxhetin e vitit 2017. Megjithëse ne e kemi pasur kërkesën më të madhe në vlerë prej 72.000 mijë €, por në dëgjimin buxhetor është përkrahur vetëm kërkesa jonë për hapjen e dy zyrave në Ferizaj dhe Gjakovë. Këto janë dy zyra rajonale ku agjencia duhet të jetë në parim të gjykatave dhe këto dy zyra kanë funksionuar më parë, por kanë qenë të mbështetura nga UNDP. Po ashtu për këto dy zyra është aprovuar edhe për dy zyrtarë ashtu siç i kanë edhe zyrtarë tjerë rajonale. Ndërkaq janë lejuar 5000 € për avokat për këto dy zyra duke pohuar se na janë ndarë gjithsej 30.000 € buxhet nga kërkesa jonë. Po ashtu kemi edhe një kërkesë tjetër prej 20.000 € për avokatët si tërësi, sepse shpesh herë ne ballafaqohemi në mungesë të hollave për pagesë të avokatëve. Gjithashtu kemi bërë kërkesë për mungesë të një zyrtari në komunën e Mitrovicës. Në fund z. Gashi shtoi se ne, si institucion, me ligj e kemi që nëpër komunat të tjera të krijojmë edhe ekupe mobile.

Lavdim Krasniqi, KPK, tha se ne, si KPK, e kemi miratuar kërkesën buxhetore për vitin 2016 dhe kjo kërkesë i ka kaluar procedurat ashtu siç parashihet në Ministrinë e Financave. Shumica e kërkesave ato që janë kryesore nuk janë plotësuar duke pohuar se kemi një lëvizje minimale që lidhen me shpenzimet kapitale, mirëpo te disa kategori, që janë shumë të rëndësishme për rritje të efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit prokurorial, nuk kemi pasur ndryshim në krahasim me

buxhetin e mëparshëm. Sfidat kryesore i kemi në rritjen e burimeve njerëzore, në sistem prokurorial, të prokurorëve dhe stafit profesional duke pohuar se nuk mund të ketë efikasitet në sistemin prokurorial me resurset aktuale, sepse këto janë dora e djathtë e prokurorit të cilat pozita për momentin nuk janë miratuar nga Qeveria. Po ashtu kemi kërkesë të vazhdueshme që të rritet komunikimi mes zyrave të prokurorive nëpër rajone, publikut dhe mediave sepse në mungesë të zëdhënësve nuk është në nivelin që kërkohet. Gjithashtu shqetësuese është edhe mungesa e sigurisë në sistem të prokurorëve, stafit, objekteve sipas standardit që ne i kemi paraqitur si kosto shtesë që deri tani nuk janë marrë parasysh. Më tej z. Krasniqi theksoi se duhet të fillojë ndërtimi i kapaciteteve brenda sistemit dhe të ketë mundësi që edhe juristëve të rinj t'i ofrohet një shumë minimale për mbulimin e shpenzimeve të cilën e kemi paraparë në kërkesë. Është një pasqyrë e qartë që shpenzimet në kategorinë mallra dhe shërbime në sistemin prokurorial është më e madhe se sa në buxhetin që është ndarë duke u bazuar në disa kategori- mbrojtja sipas detyrës zyrtare që është obligim kushtetues, ofrimi i ekspertizave për ndërmjetësues edhe dëshmitar që për këtë vit kemi mungesë rreth gjysmë milion më pak për të cilat nuk kemi mundësi t'i realizojmë obligimet ligjore që i kemi.

Besim Morina, IGJK, tha se pas paraqitjes së kërkesës sonë në dëgjimin buxhetor kërkesa jonë ka pasur rritje, por jo ajo rritje që ne kemi kërkuar për arsye se gjatë vitit 2017 pritet të organizohet trajnimi fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët të sapo emëruar pas dekretimit nga Presidenti i cili do të zgjasë 12 muaj. Duke marrë parasysh këtë i gjithë buxheti për këtë program do të shpenzohet për vitin 2017 dhe nuk do të ketë mundësi që të shpenzohet një pjesë e buxhetit 2016 ashtu siç ka qenë e planifikuar. Kërkesa jonë që nuk është aprovuar ka të bëjë me ndërtesën sepse jemi me një ndërtesë me qira ku ne me këto mjete kishim pasur mundësi të realizojmë edhe aktivitete të tjera që sot për sot nuk kemi mundësi t'i realizojmë. Ministria e Administratës Publike na është zotuar që nëse ju ndahen mjete për ndërtim edhe MAP do të na japë një parcelë ku do të ndërtohej ndërtesa Institutit, por edhe kjo kërkesë nuk ka gjetur mbështetje. Po ashtu kemi mungesë të stafit dhe me numrin e aktiviteteve që janë në realizim nuk kemi mundësi që t'i implementojmë të gjitha, kjo për faktin se ata kryen edhe një punë tjetër të dytë pa asnjë kompensim shtesë, e cila ndikon tek puna primare e tyre. Gjithashtu edhe programi për hulumtime dhe publikime ose mirëmbajtja dhe rritja e kapaciteteve të institutit të bibliotekës e cila është në funksion të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka nevojë për mbështetje financiare.

Enis Halimi, KQZ, tha se kemi pasur mirëkuptim nga Ministria e Financave për lejimin e aktiviteteve konkrete zgjedhore të vitit 2017 në zgjedhje lokale me një shumë prej 225.000 €. Problemet me të cilat ballafaqohemi kanë të bëjnë me mungesë të objektit që nuk i përmbush kushtet për punë si për nga cilësia ashtu edhe nga hapësira, sepse edhe në proces zgjedhor ne angazhojmë staf të përkohshëm për punë. Po ashtu edhe Qendra e Numërimit të Rezultateve nuk i plotëson kushtet për punë, por për përveç kësaj prona ku gjendet ky objekt është në kontest pronësor dhe pa një qendër tillë është e pamundur të funksionojë institucioni jonë apo realizimi i misionit tonë për të cilën jemi aty. Gjithashtu shqetësim tjetër i yni është trajtimi i zyrtarëve të Sekretariatit të KQZ-së në mënyrë diskriminuese për sa i takon pagave të tyre në raport me institucionet që rregullohen me të njëjtin kapitull të Kushtetutës, me BQK-në, Komisioni i Pavarur i Mediave, për Avokatin e Popullit dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të cilët janë shumë më lart se ne me paga. Stafi ynë profesional kërkon që të trajtohet në mënyrë të barabartë me stafin e këtyre institucioneve që e kemi bazën e njëjtë Kushtetuese.

Eset Rama, MD, tha se Ministria e Drejtësisë ka përcjellë kërkesat në bazë të qarkoreve buxhetore në Ministrinë e Financave dhe në Qeveri, por disa kërkesa nuk na janë mbështetur. Ne

kërkojmë të mbështetet Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimet, ku është paraparë formimi i një programi të veçantë për kompensimin e viktimave dhe anëtarëve të komisionit ku kemi kërkuar shumë prej 550.000 € nga kategoria mallra dhe shërbime. Po ashtu kërkesë kemi rreth funksionalizimit të plotë të Burgut të Sigurisë së Lartë, ku kërkohet rritje e stafit për vitin 2017, 131 pozita pastaj të shërbimi sprovues, mjekësia ligjore ku edhe ka pasur ndryshime në legjislacion për të cilat duhet mjete shtesë.

Kryetarja pyeti për ligjin e mbikëqyrjes elektronike se a ka ndarë buxhet?

Eset Rama përgjigjet duke thënë se Ministria e Drejtësisë është kompetente vetëm për hartimin, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur te Ministria e Punëve të Brendshme që duhet ta bëjë monitorimin.

Kryetarja pyeti se sa prokurorë dhe sa bashkëpunëtorë profesionalë i duhen sistemit prokurorial për të ndryshuar sa do pak sistemin e drejtësisë?

Lavdim Krasniqi përgjigjet duke thënë se aktualisht i kemi 146 prokurorë që janë duke punuar në zyrë, ndërsa para disa javësh ka përfunduar rekrutimi i 25 prokurorëve të cilët presin dekretimin nga Presidenti. Po ashtu 15 prokurorë të tjerë janë në proces të rekrutimit me marrëveshjen e Brukselit, të cilët janë pjesë procesit të integritetit të komunitetit jo shumicë dhe mbetet një numër prej 14 prokurorëve që pritet të rekrutohen vitin e ardhshëm dhe për ato është bërë kërkesa. Ndërsa lidhur me bashkëpunëtorë profesionalë në tërë sistemin prokurorial janë 9 bashkëpunëtorë profesionalë dhe planifikimi është që 2 prokurorë të kenë një bashkëpunëtor profesional dhe kërkesa është bërë 85 bashkëpunëtorë. Gjithashtu kërkesë kemi bërë edhe për kompletimin e stafit në kabinetin e Kryeprokurorit të Shtetit. Ndërkaq me hyrjen në fuqi të ligjit për përgjime, bartja e zyrës ndërlidhëse për përgjime në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit e cila për momentin është me një staf që zëvendëson stafin që duhej të ishte në këtë zyrë për të cilën kemi bërë kërkesë për buxhet.

Selviqe Halimi tha se ne, si komision, do të përpiqemi që kërkesat e juaja buxhetore të zënë vend në buxhetin e vitit 2017, sepse shihet nga një analizë e përgjithshme buxhetore janë po ato të njëjtat të cilat janë brenda limiteve dhe kërkesave ligjore. Nuk mund të flitet për implementim të ligjit për ngritje të profesionalizimit dhe përgjegjësisë po që se nuk kemi buxhet dhe njerëz kompetent për t'i kryer shërbimet e tyre. Është mangësi profesionale institucionale për të cilën kemi kohë që flasim për ligjin e pagave dhe ky ligj ende nuk po arrin të vijë në Kuvend për miratim në mënyrë që mos të kemi laramani të pagave, sepse përgatitja e kuadrove profesionale për të kryer shërbime të caktuara në institucionet e vendit kërkon edhe trajtim të barabartë me paga. Largimi i punonjësve për shkak të pagave pas një investimi që ata të jenë ekspertë në fusha të caktuara vërtet do të shkaktonte një kaos.

Armend Zemaj tha se tani e kemi bërë si praktikë që të shqyrtohen kërkesat buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit dhe po shihet qartë që është arritur efekti ku tregon vetë fakti që kërkesa buxhetore e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas është përkrahur. Ka qenë një nga institucionet që e kemi trajtuar me seriozitet shumë të madh duke pas parasysh dhe orientimin tonë për çfarë kemi dashur të realizojmë këtë mbështetje. Detyrim i joni ka qenë të ndikojmë përmes komisionit të ju që në objektivat që ju do të realizoni të ngrihet performanca dhe roli i institucioneve tuaja. Është mirë që të merren prioritetet që janë të nevojshme për ngritjen e performancës dhe efikasitetit të çdo institucioni. Ndër të tjera Zemaj tha se asnjërin nga ju nuk e dëgjova për kursim të buxhetit apo për tentim të kursimit të buxhet që t'i bartni

mjetet aty ku janë më të nevojshëm sepse ne në fund të vitit e trajtojmë edhe raportin e shpenzimeve tuaja dhe jo rrallë herë keni dalë me shpenzime enorme. Mendoj që kur të hartohet buxheti duhet të shohim edhe mundësitë reale dhe kërkesat që janë të nevojshme për kryerjen e mandatit duhet të ketë mbështetje buxhetore. Po ashtu edhe për mua mbetet shqetësuese që ende nuk kemi një harmonizim të pagave në Republikën e Kosovës. Z. Zemaj kërkoi që të rritet performanca dhe të kërkohet llogaridhënia për të gjitha këto aktivitete dhe së bashku t'ju mbështesim në këtë drejtim. Më tej z. Zemaj shtoi se ne kërkesat buxhetore do t'i trajtojmë me seriozitet sikurse i kemi trajtuar edhe kërkesat të tjera buxhetore, por besoj se do të hasim edhe në mirëkuptimin e hartuesit të buxhetit Ministrisë së Financave që aty ku kanë mundësi të ndërhyjnë dhe aty ku është e domosdoshme të ndërhyjnë edhe në këtë fazë.

Pal Lekaj tha se ne, si komision, kërkesat buxhetore duhet trajtojmë ashtu siç duhet nëse ne i kemi dhënë prioritet këtyre institucioneve dhe sidomos drejtësisë në Kosovë atëherë me të drejtë themi se kërkesat tuaja për të pasur efikasitet duhet t'i përkrahim fuqishëm. Për Agjencinë Juridike Falas mendoj se kanë nevojë për ndihmën tuaj se qytetari dita ditës po varfërohet dhe shuma prej 30.000 € është shumë pak duke pohuar se duhet një staf më i madh sepse nëse i shohim raportet që na vinë nga qytetarët kanë nevojë për ndihmën tuaj ndaj kërkesat janë legjitime. Ndërsa sa i përket Këshillit Prokurorial duke u bazuar se kanë shumë lëndë dhe për të pasur efikasitet duhet të investojmë në resurse njerëzore ndaj kërkesat tuaja duhet të përkrahen. Po ashtu Qeveria duhet të ju përkrahë edhe lidhur me sigurinë e sistemit prokurorial sepse duhet të mendojë më ndryshe për ju nëse kërkohet të ketë efikasitet dhe një luftë të pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Programet dhe trajnimet në Institut Gjyqësor janë të domosdoshme, sepse nëse ne kërkojmë njerëz profesionistë për të hulumtuar një fushë të caktuar duhet të ju mbështesim financiarisht dhe nëse nuk sundojmë ligjin në këtë vend, nuk ofrojmë kushte atëherë kot ne mendojmë për zhvillim ekonomik apo gjëra tjera dhe me këtë buxhet mendoj se jemi shumë larg performancës që ne kërkojmë nga ju. Më tej z. Lekaj tha se të gjitha institucionet duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë sa i përket pagave. Ndërsa sa i përket kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë për staf në shërbimin sprovues mendoj se duhet të përkrahen sepse edhe ata që kanë bërë krime duhet të trajtohen në nivelin më të mirë të mundshëm.

Agim Aliu tha se ne do të vazhdojmë t'i përkrahim kërkesat tuaja buxhetore si komision dhe si deputetë me të gjitha format që ne mund t'i kemi në dispozicion në mënyrë që puna juaj të jetë më e lehtë, efikase dhe efektive. Ajo çfarë mua më shqetëson më shumë është se përse ne duhet të dorëzohemi para presionit ndërkohë që këto çështje që u thanë këtu do të duhej të ishin objektiva dhe prioritet të Qeverisë. Ndër të tjera z. Aliu tha se është dashur një presion kaq i madh për hapjen dhe funksionimin e dy zyrave për Ndihmë Juridike Falas në Ferizaj dhe Gjakovë duke pohuar se ka qenë një kërkesë buxhetore shumë e vogël. Do doja të silleshim si shtet për ndërtimin e ndërtesave për t'i dhënë prioritet në ndarjen e buxhetit të kategorisë investime/kapitale. Ne ende për nga ndërtesat Qeveritare nuk i ngjasojmë shtetit duke pohuar se ne duhet të ndërtojmë objekte presidenciale, qendra protokollare, por është për të ardhur keq që ne do duhet të presim një kohë të gjatë sepse buxheti pothuajse është i kontraktuar për 3 vjet.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryetarja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime kërkoi:

Nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve që brenda 2 ditësh të sjellin edhe me shkrim kërkesat e tyre buxhetore në mënyrë që të shqyrtohen edhe në takimin tjetër të Komisionit.

4. Njoftim me shkresën e Institutit Gjyqësor të Kosovës për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues

Kryetarja njoftoi anëtarët e Komisionit për shkresën e Institutit Gjyqësor të Kosovës për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë diskutim.

Meqë nuk kishte diskutime, kryesuesja konstatoi se komisioni u njoftua për shkresës të cilën e kishin kërkuar anëtarët e komisionit Agim Aliu dhe Armend Zemaj.

5. Të ndryshme

A. Njoftim për vizitën në Shqipëri

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit për ftesën e bërë nga Komisioni i Ligjeve në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë duke u përfaqësuar secili Grup Parlamentar me nga një deputet të cilët do të jenë pjesë e delegacionit që do të vizitojë Shqipërinë më 5-6 dhjetor.

Pas diskutimeve kryesuesja, konstatoi se Komisioni vendosi që delegacioni për vizitë në Shqipëri të jetë në këtë përbërje:

Albulena Haxhiu- kryetare,
Danush Ademi- nënkryetar,
Agim Aliu –anëtar,
Armend Zemaj- anëtar,
Pal Lekaj- anëtar,
Valdete Bajrami-anëtare.

B. Kërkesa e Grupit për Studime Politike dhe Juridike për Javën Kundër Korrupsion për caktimin e një Dëgjimi Publik

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit për kërkesën e Grupit për Studime Politike dhe Juridike se lidhur me Javën Kundër Korrupsion ata kanë kërkuar të mbajmë një dëgjim publik duke ftuar ministren e Drejtësisë, znj. Dhurata Hoxha dhe drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion.

Lidhur me këtë Komisioni vendosi që Dëgjimi Publik të mbahet më, 7 dhjetor duke i ftuar ministren e Drejtësisë dhe drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion.

C. Diskutim për prezantimin e projektit të KDI-së për Komisionin për Legjislacion

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit për prezantimin e projektit të KDI-së për Komision për Legjislacion dhe ia dha fjalën përfaqësueses së KDI-së për këtë projekt.

Jeta Krasniqi tha se projekti i KDI-së është i fokusuar në Dialogun Kosovë –Serbi për të cilën ne ju ofrojmë mbështetje lidhur me këtë dialog.

Armend Zemaj kërkoi nga KDI që të nxirren dhe të ndahen temat se ku Komisioni jonë do të monitoroj marrëveshjet nga fushëveprimi i tij.

Lidhur me këtë Komisioni u dakordua që të ketë bashkëpunim edhe në këtë fushë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:26.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu